



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.03.2026

Numër Protokolli: 1636/2026

A.nr.196/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.196/2026, të datës 24.02.2026, të parashtruar nga ankuesi B.M, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Zyra e Avokatisë Klinaku&Associates nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.196/2026, të datës 24.02.2026 e parashtruar nga ankuesi B.M.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.M (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), përmes përfaqësuesit më autorizim Zyrës së avokatisë Klinaku&Associates, më datë 20.02.2026, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 24.02.2026 dhe e regjistruar nën shenjë A.nr.196/2026, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë, lidhur më mos shqyrtimin e kërkesës së datës 27.08.2025 siç përcaktohet me Vendimin e KPMSHCK-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 10.03.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit më datë 13.03.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 971/2026 të datës 24.02.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Zarin e datës 20.02.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 13.03.2026; Akt Emërimit e datës 07.07.2014; Përshkrimin e detyrave të punës për Inspektor Sanitar; Kërkesën e datës 27.08.2025 të ankuesit për kompensim e pagës shtesë për punën jashtë orarit; Autorizim për shërbime ligjore; Vendimin me Nr.03/02/2026 të datës 27.02.2026 të U.D Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë; Kërkesën e datës 22.04.2024 nga Udhëheqësi i Inspektoratit Sanitar për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë; Lista e Inspektorëve Sanitar për Regjionin e Prishtinës; E-mailin e datës 25.03.2026 nga E.P për ankuesin për dërgimin e Vendimin me Nr.03/02/2026 të datës 27.02.2026.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.196/2026, *sepse:*

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të çështjes rrjedhë se: Ankuesi ushtron pozitën Inspektor Sanitar, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe se i njëjti më datë 27.08.2025, ka parashtruar kërkesë për kompensim e pagës shtesë për punën jashtë orarit tek Ministria e Shëndetësisë, dhe duke qenë se nuk kishte pranuar përgjigje nga organi i punësimit ka parashtruar ankesë në KPMSHCK më 08.09.2025, ndërsa, ky i fundit më Vendimin A.nr.1671/2025, të datës 18.11.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e detyruar Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë për shqyrtimin e kërkesës së ankuesit të datës 17.08.2025.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar pretendon se Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Shëndetësisë, edhe përkundër Vendimit A.nr.1671/2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka shqyrtuar kërkesën e datës 27.08.2025. Propozon që të nxirret akti administrativ dhe të vendoset sipas kërkesës së datës 27.08.2025, ose në të kundërtën të detyrohet organi i shkallës së parë që të rishqyrtoj dhe të vendose lidhur me kërkesën e palës.

III. Përgjigja në ankesë e Ministrisë së Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë, në përgjigjen në ankesë të datës 13.03.2026, ka përcjell Vendimin me Nr. 03/02/2026 të datës 27.02.2026, të u.d Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, i nxjerr si rezultat i zbatimit të Vendimit A.nr.1671/2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e më të cilin është shqyrtuar kërkesa e datës 27.08.2025 e palës ankuese dhe e njëjta është refuzuar me arsyetimin se ekzekutimit i pagesave behët vetëm kur respektohet procedurat sipas legjislacionit në fuqi, rrjedhimisht me arsyetimin se puna jashtë orarit paraprakisht duhet të miratohet

nga Zyrtari Kryesor Administrativ, të mbahet evidenca për orët shtesë dhe të përcillet dosja e kompletuar për kompensimin në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

IV. Vlerësimi i Kolegjit

Duke qenë së ankesa e ankuesit ka për objekt ankimor heshtjen e organit të punësimit ndaj mos shqyrtimit të kërkesës së datës 27.08.2025 sipas Vendimit të KPMSHCK-së A.nr.1671/2025, dhe meqenëse organi i punësimit gjatë procedurës ankimore, rrjedhimisht më rastin e parashtrimit të kundërshtimeve të pretendimeve ankimore ka përcjell Vendimin me Nr. 03/02/2026 të datës 27.02.2026, lidhur më shqyrtimin e kërkesës së ankuesit të datës 27.08.2025, atëherë, mbi këto rrethana Kolegji vlerëson së objekti/qëllimi i ankesës është arritur-realizuar dhe është konsumuar heshtja administrative e organit të punësimit.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës ankuesi ka pranuar (në adresë emailin zyrtar) më datë 26.03.2026 Vendimin Nr. 03//02/2026, të datës 27.02.2026, të NJBNJ të Ministrisë së Shëndetësisë) më udhëzimin juridik që ndaj të njëjtit mund të ushtroj ankesë në KPMSHCK, pra, në rast se ankuesi nuk është i kënaqur me këtë vendim atëherë i njëjti brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita e pranimin të vendimit mund të ushtroj ankesë në KPMSHCK.

Andaj, nisur nga konstatimet si më sipër, e në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”, Kolegji konstaton së procedura administrative e filluar më ankesën A.nr.196/2026 duhet të përfundoj, pasi që objekti i ankesës është realizuar dhe si i tillë është bërë i pamundur.

Thënë si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.196/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit *Klinaku&Associates*;
- Udhëheqësit të *Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe*
- Arkivit të *KPMSHCK-së*.